

asnjë

njeri nuk

është

ilegal

**Pa letra -**

**ti ke të drejta!**

Ky botim ekziston në gjuhën shqipe, gjermane, franceze, spanjolle, portugeze, boshnjake/kroate/serbe, turke dhe angleze.

2012 - Botim i Sindikatës Unia dhe i këshillimoreve për «Sans Papier» për Zvicrën gjermano-folëse.

# A jeton dhe punon në Zvicër pa leje qëndrimi?

Atëherë nuk je vetëm! Në Zvicër jetojnë më së paku 100'000 njerëz si ti. Atyre u thonë «Sans Papiers» (Pa Letra) ose «Ilegalë». Shumica prej tyre janë në të vërtetë «Punëtor/e me leje-qëndrim të parregulluar». Ata pastrojnë, kujdesen për fëmijë, punojnë në ndërtimtari, nëpër restorante apo te bujqit.

Edhe nëse ti jeton në Zvicër pa leje qëndrimi, ke të drejta themelore. Të drejtat e njeriut nuk janë të ndërlidhura me statusin e qëndrimit. Ato vlejnë për të gjithë.

Kjo fletushkë përmban informata të dobishme mbi jetën e përditshme dhe të jep sqarime mbi të drejtat tua elementare. Ndihmë mund të japin edhe këshillimoret për «Sans Papiers», grupet e solidaritetit, sindikatat ose avokate/ët (shiko adresat në fund).



# 1. Legalizimi i qëndrimit

**Njerëzit jashtë BE-së nuk kanë gati kurrfarë mundësish për të marrë leje qëndrimi në Zvicër. Për «Sans Papiers»ekzistojnë faktikisht vetëm mundësia e lejes së qëndrimit për raste të rënda apo martesë.**

## **Leje-qëndrimi për raste të rënda**

Ligji parasheh që migrantë/et, të cilët qëndrojnë në Zvicër pa bazë ligjore, duhet menjëherë të lëshojnë Zvicrën, përveçse nëse është fjala për raste të rënda personale. Një vendim për largim duhet të merret nga enti kompetent për migracion.

Në raste të rënda mund të parashtrohet kërkesa individuale për rregullimin e qëndrimit. Autoritetet e trajtojnë çdo kërkesë në mënyrë individuale. Gjatë trajtimit, me rëndësi janë kriteret si kohëzgjatja e qëndrimit në Zvicër, puna, integrimi, shkollimi i fëmijëve, shëndeti dhe të tjera.

Autoritetet konsiderojnë se qëndrimi prej më pak se pesë vite në Zvicër nuk paraqet rast të rëndë. Vetëm në rast të një qëndrimi më të gjatë kërkesa

trajtohet në mënyrë serioze. Veç kësaj, ardhmëria e këtyre rregullimeve individuale të rasteve të rënda sot (2012) është shumë e pasigurt.

Ish-azilkërkuesit, të cilët janë zhdukur (në ilegalitet) e kanë edhe më vështirë: Për ta parimisht nuk ekziston mundësia e një procedure të re, madje as për një kërkesë për raste të rënda.

**Kujdes!** Vendimmarrja për kërkesat në rastet e rënda është në kompetencë të Kantoneve, kurse në rastet e miratimit të kërkesës duhet edhe pajtimi i Federatës. Për rastet e rënda autoritetet gjithmonë vendosin në mënyrë subjektive apo sipas mendimit të tyre. Veç kësaj, praktika për rastet e rënda ndryshon varësisht nga kantoni, prandaj informohu tek njëra nga këshillimoret.

## **Martesa**

Secili njeri ka të drejtë të martohet. Mirëpo, në jetën e përditshme kjo për njerëzit pa letra nuk është e lehtë, pasi që mungon leja e qëndrimit. Që nga fillimi i vitit 2011 të gjithë shtetasit e huaj që duan të martohen duhet të dëshmojnë lejen e qëndrimit ligjor në Zvicër. Veç kësaj, ofiqaritetë

(zyrat e gjendjes civile) janë të obliguara që t'i informojnë autoritetet e migracionit për qëndrimin ilegal të njërit nga bashkëshortët në Zvicër. Gjyqi Federal ka vendosur që «Sans Papiers» nuk duhet t'u mohohet në përgjithësi martesë në Zvicër. Kjo do të thotë se çdo rast duhet të trajtohet individualisht. Praktika për rastet e rënda ndryshon varësisht nga kantoni, prandaj, në lidhje me procedurën informohu tek njëra nga këshillimoret.

Nëse martesë nuk është e mundur në Zvicër, ti duhet të kthehesh në vendlindjen tënde, atje të martohesh dhe pastaj të bësh një kërkesë për bashkim familjar në Zvicër apo të kërkohesh një vizë me qëllim të përgatitjes së martesës në Zvicër, në mënyrë që ti të mund të udhëtosh ligjërisht në Zvicër. Në lidhje me procedurën informohu tek njëra nga këshillimoret.

Nëse dyshohet se martesë është e rrejshme, atëherë ofiqari/ja mund të refuzojë lidhjen e martesës.

**Kujdes!** Nëse bashkëshortët ndahen brenda tri viteve të para të martesës, kërcënon humbja e lejes së qëndrimit.

## **Kërkesa: Rregullimi kolektiv**

Njerëzit pa letra së bashku me grupet përkrahëse luftojnë me vite për një rregullim kolektiv në Zvicër. Disa suksese janë arritur: mbi një mijë leje të qëndrimit dhe e drejta për sigurim shëndetësor. Në regjionet në të cilat «Sans Papiers» janë të organizuar mirë mund të hapen rrugë të reja. Kështu, një fushatë e madhe në Gjenevë ka bërë që ky kanton në janar 2005 të kërkojë nga Berna 5000 leje qëndrimi për të punësuarat në amvisni.

**Prandaj, angazhohu në njërën nga kolektivët e ndryshme për njerëz pa letra!**



## 2. Shëndeti

**«Sans Papiers» jetojnë në kushte të rënda. Puna shpesh është e rëndë dhe e dëmshme për shëndetin. Kësaj i shtohet stresi i jetesës pa leje-qëndrim të rregulluar, larg vendlindjes dhe familjes. Të gjitha këto mund të kenë pasoja për shëndetin tënd dhe mirëvajtjen tënde shpirtërore. Dhimbjet e shpinës, gjendja e keqe shpirtërore dhe depresionet janë shenja alarmuese, të cilat duhet t'i marrësh seriozisht.**

Mos jeto vetëm për të tjerët dhe për të ardhmen e largët. Gjej kohë sot për gjërat të cilat i bën me dëshirë. Bashkohu me të tjerët, për të shpërthyer izolimin.

Udhëzuesi për shëndetësi i Kryqit të Kuq të Zvicrës, Caritas-it dhe Entit Federal për Shëndetësi (BAG) të ofron informata të tjera (mund të tërhiqen në këshillimoret për Sans Papiers apo në [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)).

## **E drejta për shërbime shëndetësore**

Shëndeti është e drejtë e njeriut edhe për Sans Papiers! Nëse je i sëmurë ose i lënduar, atëherë duhet të të mjekojnë, edhe nëse nuk ke sigurim shëndetësor.

Në spitale ekzistojnë punëtorë/et sociale. Ata/o mund të të ndihmojnë në rast të problemeve.

Mjekë/et dhe personeli i spitalit janë të detyruar/a të ruajnë fshehtësinë. Ata/ato nuk guxojnë t'ia japin policisë apo Entit për migracion të dhënat tua. Shkelja e obligimit për ruajtjen e fshehtësisë është e dënueshme.

## **E drejta për sigurim shëndetësor**

Ti ke të drejtë të bësh një kontratë të sigurimit shëndetësor dhe raste fatkeqësie. Shpenzimet e mjekimeve, qëndrimeve në spital, shtatzënisë dhe lindjes mbulohen nga arkat e sigurimit shëndetësor. Mjekimi i dhëmbëve nuk është i siguruar.

Sigurimi shëndetësor në Zvicër nuk është falas. Për çdo muaj ti paguan një kontribut të quajtur

“Premi”. Përveç Premisë ti duhet të marrësh përsipër edhe një pjesë të shpenzimeve të trajtimit mjekësor, një kontribut vjetor fiks “Franchise”. Posa të tejkalojnë shpenzimet e trajtimit Franshizën, duhet të paguhen edhe 10% të shpenzimeve të trajtimit vetë (Selbstbehalt). Në disa Kantone ekziston mundësia e kërkesës për lirim të premisë (Reduktimi), nëse të ardhurat janë të ulëta (informohu në këshillimore).

Edhe arkat e sigurimit i nënshtrohem ruajtjes së fshehtësisë. Megjithatë ne të rekomandojmë, që gjatë lidhjes së kontratës së sigurimit të japësh adresën e një personi «legal» të besueshëm.

## **Shtatzënia dhe mbrojtja nga sëmundjet (HIV-SIDA, sëmundje tjera seksuale)**

Mjekët, spitalet dhe këshillimoret të posaçme informojnë mbi mjetet e parandalimi të shtatzënisë dhe abortimi (adresa në fund) Prezervativët (gomat) të mbrojnë gjatë marrëdhënies seksuale nga HIV/Sida dhe sëmundjet tjera seksuale. Ato mund të blihen pa recetë në barnatore apo shtëpi të mallrave. Testet për HIV mund të bëhen me shpenzime të vogla dhe në mënyrë anonime në vende të specializuara.

Informata për temën e HIV/SIDA gjen në gjuhë të ndryshme në [www.aids.ch](http://www.aids.ch) apo [www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)

## 3. Puna

**Nëse ti me ndonjë person merresh vesh, që të punosh për të dhe ai ty të premtun një rrogë, atëherë kjo vlen si kontratë pune, edhe nëse marrëveshja është bërë gojarisht.**

### **Kontrata të garanton kushte minimale të punës:**

- Të drejtë për rrogë të zakonshme të profesionit dhe vendit.
- Të drejtë për pushime të paguara (në të shumtën e rasteve 4 javë në vit).
- Vazhdimësia e pagesës së rrogës gjatë një kohe të caktuar në rast sëmurje apo fatkeqësie.
- Te të miturit: Ndalim pune për moshën më të ulët se 15 vjeç. Nën 18 vjeç ndalim punë natën dhe të dielën. Më së shumti çdo ditë 9 orë pune. Nëse punon si punëtoore e amvisërisë (shtëpiake) dhe banon te punëdhënësi yt, atëherë ata duhet të të japin hapësirë banimi, e cila e mbron sferën tënde private.

- Afate të arsyeshme të prishjes së kontratës. Punëdhënësi/ja duhet të informojë herët, nëse ai/ajo nuk do të të punësojë më tutje.
- Sigurimi i pleqërisë dhe i të mbeturve AHV dhe sigurimi në rast të invaliditetit IV (shiko kapitullin sigurimet sociale)

Njerëzit pa letra shpesh marrin rroga të ulëta apo nuk marrin fare. Nëse biseda e drejtpërdrejtë me punëdhënësin nuk sjellë rezultate, atëherë në disa kantone ke të drejtë padie pranë gjyqit të punës.

Informohu te ndonjë sindikatë apo këshillimore! Padinë para gjyqit mund ta bëjë edhe ndonjë person i autorizuar nga ti. Kështu që ti mundesh, edhe në rast kthimi në vendlindje, deri pesë vite më vonë të kërkosh të drejtat tua nëpërmjet gjyqit.

**Këshillë:** Nëse prezantohesh për herë të parë te punëdhënësi, Atëherë parashtro pyetje në lidhje me punën: sa do të fitosh? Sa orë duhet të punosh? Cilat punë duhet t'i bësh e cilat jo? Sipas mundësisë, merru vesh për orar të caktuar.

Kjo është me rëndësi sidomos ti nëse banon te punëdhënësi/ja (të punësuarit në amvisni). Gjithashtu merru vesh, se cilat ditë i ke të lira. Pyet, se a mund t'i kesh me shkrim këto marrëveshje (kontratë pune). Për këtë punëdhënësi/ja është e obliguar me ligj (shih Obligationenrecht Neni 330b).

**Këshillë:** Shkruaj çdo ditë sa dhe çka ke punuar. Ruaji fletët që përmbajnë udhëzime pune. Nëse e ke dokumentuar punën e bërë, atëherë do ta kesh më lehtë t'i nxjerrësh të drejtat e tua, nëse ke probleme me punëdhënësi/en.

**Këshillë:** Ti si Sans Papier mund të anëtarësohesh pa vështirësi në ndonjë Sindikatë. Kjo mund të të ndihmojë p.sh. të të përcjellë në proceset gjyqësore.

## **Sigurimet sociale**

Sigurimet sociale janë të obligueshme për të gjithë njerëzit që jetojnë në Zvicër. Kryesoret janë: Sigurimi i pleqërisë dhe për të mbeturit (AHV), Sigurimi në rast invaliditeti (IV/), Sigurimi i papunësisë (ALV), Sigurimi i fatkeqësisë (UVG) dhe Përkujdesja profesionale (BVG, Arka e Pensionit).





Secili/a punëdhënës/e duhet t'i lajmërojë punëtorët te sigurimi social. Këto nuk guxojnë të lajmërojnë njerëzit pa letra te policia për të huaj. Informohu pranë një këshillimore.

Nëse ti je i lajmëruar pranë sigurimit social, do të marrësh një **legjitimacion i sigurimit**, (kartë e AHV-së). Punëdhënësi yt ende të punëson ilegalisht, mirëpo ti je i siguruar kundër invaliditetit dhe në pleqëri e merr një pension (edhe në vendlindje).

**Vini re!** Ekzistojnë punëdhënës/e, të cilët kontributet e sigurimeve sociale i zbresin nga rroga, mirëpo nuk i paguajnë te sigurimet! Nëse ti nuk e ke kartën e AHV-së, d.m.th. punëdhënësi/ja yt/jote nuk të ka siguruar.

**Këshillë:** Bisedo me punëdhënësi/en tënd/e mbi mundësitë e lajmërimit te sigurimet sociale. Informohu paraprakisht mbi praktikën e zakonshme në kantonin e banimit.

**Këshillë:** Informohu gjithsesi para kthimit në vendlindje për mënyrën e pagesës dhe për sigurimet sociale.

## 4. Kopshti për fëmijë dhe shkolla

**Shkollat publike janë të detyruara të bëjnë shkollimin e të gjithë fëmijëve, të cilët jetojnë në Zvicër, pa marrë parasysh statusin e qëndrimit-d.m.th. edhe fëmijët e njerëzve pa letra. Kjo vlen deri në përfundimin e shkollimit të obligueshëm (klasën e 9). Edhe regjistrimi në kopsht i fëmijëve në shumë kantone është i obligueshëm.**

Në disa kantone ekziston mundësia e vazhdimit të shkollimit (p.sh në gjimnaz). Shkollimi profesional për të rinjtë «Pa letra» nuk është i mundshëm. Një ndryshim i ligjit nuk është paraparë.

Shkolla dhe mësuesi/et nuk guxojnë t'i japin policisë të dhënat mbi fëmijët.

**Këshillë:** Mësueset/it janë persona të besueshëm dhe gati gjithmonë kanë mirëkuptim për situatën e vështirë të fëmijëve të njerëzve pa letra. Merr pjesë në mbrëmje të prindërve dhe manifestime tjera të shkollës. Nëse ke frikë, shko me përcjellje.



## 5. Kurset e gjuhës

**Ne të sugjerojmë të mësosh gjuhën lokale. Njohja e gjuhës është një përparësi e madhe në jetën e përditshme. Kështu mund të marrësh pjesë në jetën e përditshme në vend dhe mund të angazhohesh në mënyrë efektive për të drejtat tua. Pyet në këshillimoret për kurse të përshtatshme të gjuhës.**



## 6. Banimi

**Pa leje qëndrimi është vështirë për të gjetur banesë. Sans Papier shpesh paguajnë qira të shtrenjta dhe kanë banesa të vogla.**

Kjo funksionon më së lehti nëse banesën e merr me qira në emër të një personi, i cili ka leje qëndrimi. Mirëpo, ky person shkelë ligjin dhe mund të dënohet.

Pronari/ja nuk guxon të kërkojë qira më të madhe se qiratë e zakonshme të rrethinës. Edhe qiraja nuk mund të jetë shumë më e lartë se ajo e personit që ka banuar aty më herët.

Pronari/ja mund të kërkojë depozitim të qirasë deri në shumën maksimale prej 3 qirave mujore. Nëse ti e paguan qiranë me kohë dhe nuk bën dëme në banesë, atëherë kjo depo duhet të të kthehet, sapo të largohesh nga banesa. Kërko një faturë për depozitën e paguar.

**Këshillë:** Pyete pronari/en për fletëpagesa. Paguaje banesën në postë me emrin tënd të vërtetë. Fletëpagesat janë dëshmia më e mire për qiratë e paguara, edhe nëse më vonë i parashtron kërkesa për kthim të mjeteve pronarit/es.

**Këshillë:** Nëse pronari/ja kërkon qira tepër të lartë ose nuk e kthen shumën e depozituar, atëherë përpigu nëpërmjet njërës nga këshillimoret të bisedosh me të. Nëse kjo nuk ka sukses, atëherë në disa vende ekziston mundësia për t'u ankuar te një «vend pajtimi».

# 7. Policia

**Nga këndvështrimi i autoriteteve ti si Sans Papier e shkelë ligjin vetëm me faktin se qëndron në Zvicër pa letra. Puna pa leje është edhe një shkelje shtesë e ligjit.**

Nëse autoritetet marrin vesh se qëndron në Zvicër pa letra, në shumicën e rasteve do të largohesh nga Zvicra dhe të ndalohet hyrja në vend për 2-3 vite. Përveç kësaj, mund të dënohesh me gjobë ose me burg.

Policia për të huaj mund të urdhërojë arrest për largim. Ti do të mbahesh në arrest deri sa autoritetet i rregullojnë formalitetet për largimin tënd. Ligjshmëria e këtij arresti duhet të shqyrtohet nga një gjykatës brenda 96 orësh. Arresti për largim, plus arresti i mundshëm për realizimin e dëbimit, mund të zgjasin më së shumti 18 muaj. Kundër urdhërarrestit ti mund të bësh ankesë, mirëpo kjo kushton. Vazhdimi i ndalimit duhet të shqyrtohet çdo tre muaj pas dëgjimit nga një gjyqtar/e. Para vazhdimit të ndalimit kërko një avokat (pa pagesë).

## **Kontrollet policore dhe të drejtat tua**

- Policia ka të drejtë të të ndalojë dhe të verifikojë të dhënat personale.
- Pa leje qëndrimi sipas të gjitha gjasave do të të marrin në stacion policor. Aty kërko të të mundësohet kontakti me një avokat ose këshillimore.
- Pastaj pason marra në pyetje. Personi i cili të merr në pyetje duhet të të trajtojë në mënyrë korrekte: pa kërcënime, pa dhunë fizike.
- Për marrjen në pyetje kërko një përkthyes/e. Mos u përgjigj dhe mos nënshkruaj kurrë asgjë, nëse nuk ke kuptuar gjithçka saktësisht.



- Ti ke të drejtë të refuzosh të deklaratat. Nuk je i detyruar të japësh informata për adresën tënde, punëdhënësit ose miqtë. Mund të përgjigjesh: «Nuk kam çfarë të them në lidhje me këtë». Më së miri është të mos thuash asgjë, se sa të gënjesht. Gënjeshttrat kuptohen shpejtë dhe ti bëhesh i pabesueshëm. Të dhënat tua personale si emri, mbiemri, data e lindjes dhe prejardhja, duhet t'i japësh.
- Gjatë kontrollit të thjeshtë, policia nuk ka të drejtë që pa arsye të bëjë kontroll të trupit, d.m.th. të të prekë nëpër trup ose madje në pjesë intime. Nëse megjithatë të kontrollojnë, atëherë kërko që këtë ta bëjë një person i gjinisë tënde.

- Policia ka të drejtë të bastisë banesën vetëm me urdhëresën për bastisje të shtëpisë. Bazuar në Ligjin për të huajt (Neni 70), gjatë procedurës së largimit apo përzënies, edhe pa urdhërbastisjen e gjykatës mund të kontrollojë personin e kërkuar si dhe gjësendet që mban me vete, për të siguruar dokumentet e udhëtimit dhe të identifikimit.
- Kërko dëshmi (vërtetime) për gjërat, të cilat policia i ka konfiskuar. Kërko, që gjërat, si shënimet personale, kalendarin ose të ngjashme të vulosen dhe të mbyllen. Nëpunësit e policisë nuk kanë të drejtë t'i lexojnë ose të bëjnë kopje të tyre. Vetëm gjykatësi/ja hetues/e ka të drejtë të heq vulën.
- Lajmëro patjetër shpërdorimet pranë organizatës për të drejtat e njeriut «Augenauf».

# Adresa të dobishme

## Aargau

### **Spagat, Sans-Papiers Anlaufstelle AG/SO für Gesundheit und soziale Fragen**

Augustin-Keller-Strasse 1, 5001 Aarau,  
T +41 62 836 30 20, Mobile +41 79 728 60 96 (çështje sociale),  
Mobile +41 79 728 58 97 (shëndetësi), spagat@heks.ch,  
www.sans-papiers.ch

## Bazel

**Anlaufstelle für Sans-Papiers** Rebgasse 1 (Kati i parë), 4058 Basel,  
Këshillimore ligjore dhe sociale: T +41 61 681 56 10, Këshillimore shëndetësore dhe përkujdesjeje: T +41 61 683 04 21, basel@sans-papiers.ch,  
www.sans-papiers.ch

**Augenaufl** Postfach, 4005 Basel, T +41 61 681 55 22, www.augenaufl.ch

**Gewerkschaft Unia** Rebgasse 1, CH-4058 Basel, T +41 61 686 73 00,  
www.nordwestschweiz.unia.ch, www.unia.ch

### **Union der Arbeiter/-innen ohne geregelten Aufenthalt**

c/o Interprofessionelle Gewerkschaft der Arbeiter/-innen (IGA),  
Oetlingerstrasse 74, 4057 Basel, T +41 61 681 92 91,  
www.viavia.ch/iga

## Bern

**Berner Beratungsstelle für Sans-Papiers** Eigerplatz 5, 3007 Bern,  
T +41 31 385 18 27, beratung@sans-papiers-contact.ch,  
www.sans-papiers.ch

**Augenaufl** Quartiergasse 17, 3013 Bern 11, T +41 31 332 02 35  
(Mo 16–20 Uhr, sonst Anrufbeantworter), www.augenaufl.ch

**Bleiberecht-Kollektiv Bern** bern@bleiberechtfueralle.ch,  
www.bleiberechtbern.ch

**Gewerkschaft Unia** Monbijoustr. 61, 3001 Bern, T +41 31 385 22 22,  
www.bern.unia.ch, www.unia.ch

## Bern

### **Kirchliche Anlaufstelle Zwangsmassnahmen Kanton Bern**

Postfach 465, 3000 Bern 25, T/F +41 31 332 00 50,  
[www.refbejuso.ch/inhalte/migration-integration/zwangsmassnahmen.html](http://www.refbejuso.ch/inhalte/migration-integration/zwangsmassnahmen.html)

### **Schweizerisches Rotes Kreuz, Gesundheitsversorgung für**

**Sans-Papiers** Werkstrasse 16, 3007 Bern, T +41 31 960 77 77,  
T +41 79 666 95 72, [gesundheit-sanspapiers@redcross.ch](mailto:gesundheit-sanspapiers@redcross.ch),  
[www.redcross.ch/activities/health/sanspapier/index-de.php](http://www.redcross.ch/activities/health/sanspapier/index-de.php)

**Zentrum für Familienplanung** Effingerstrasse 102, Geschoss D,  
3010 Bern, T +41 31 632 12 60, [familienplanung.fkl@insel.ch](mailto:familienplanung.fkl@insel.ch)

## Fribourg

**Centre de contact suisse-immigrés (CCSI)** Rue des alpes 11,  
1700 Fribourg, T +41 26 424 21 25, [www.ccsi-fr.ch](http://www.ccsi-fr.ch)

**Fri-Santé, Permanence médicale** 12, rue François-Guillimann,  
1700 Fribourg, T +41 26 341 03 30, [www.fri-sante.ch](http://www.fri-sante.ch)

**Syndicat Unia** Route des Arsenaux 15, 1700 Fribourg,  
T +41 26 347 31 31, [www.fribourg.unia.ch](http://www.fribourg.unia.ch), [www.unia.ch](http://www.unia.ch)

## Gjenevë

**Collectif de soutien aux sans-papiers** 25, rte des Acacias,  
1227 Les Acacias, Genève, T +41 22 301 63 33,  
[collectifsanspapiers@ccsi.ch](mailto:collectifsanspapiers@ccsi.ch), [www.sans-papiers.ch](http://www.sans-papiers.ch)

**Collectif des travailleuses et travailleurs sans statut légal (CTSSL)** c/o Centre de contact suisses-immigrés (CCSI),  
25, rte des Acacias, 1227 Genève, T +41 79 218 30 56

**Syndicat Unia** 5, chemin Surinam, 1211 Genève, T +41 22 949 12 00,  
[www.geneve.unia.ch](http://www.geneve.unia.ch), [www.unia.ch](http://www.unia.ch)

**Syndicat SIT** Rue des Chaudronniers 16, case postale 3287,  
1211 Genève 3, T +41 22 818 03 00, [www.sit-syndicat.ch](http://www.sit-syndicat.ch)

**Centre de Contact Suisses-Immigrés (CCSI)** Route des Acacias 25,  
1227 Les Acacias, Genève, T +41 22 304 48 60, [www.ccsi.ch](http://www.ccsi.ch)

## Gjenevë

### **Consultation ambulatoire mobile de soins communautaires**

**(CAMSCO)** Rue Hugo-de-Senger 4, 1205 Genève, T +41 22 382 53 11,  
<http://premier-recours.hug-ge.ch>, rubrique «précarité/sans-papiers»

## Luzern

### **Verein Kontakt- und Beratungsstelle für Sans-Papiers Luzern**

St. Karlstrasse 23, 6004 Luzern, T +41 41 240 24 10,  
[luzern@sans-papiers.ch](mailto:luzern@sans-papiers.ch), [www.sans-papiers.ch](http://www.sans-papiers.ch)

## Solothurn

### **Spagat, Sans-Papiers Anlaufstelle AG/SO für Gesundheit und soziale Fragen**

Rossmarktplatz 2, 4500 Solothurn,  
T +41 62 836 30 20, Mobile +41 79 728 60 96 (çështje sociale),  
Mobile +41 79 728 58 97 (shëndetësi), [spagat@heks.ch](mailto:spagat@heks.ch),  
[www.sans-papiers.ch](http://www.sans-papiers.ch)

## Tessin

**Movimento dei Senza Voce** Casella Postale 4635, 6904 Lugano,  
T +41 91 647 46 47, +41 77 448 85 72, [senzavoce@bluewin.ch](mailto:senzavoce@bluewin.ch),  
[www.movimentodeisenzavoce.org](http://www.movimentodeisenzavoce.org), [www.sans-papiers.ch](http://www.sans-papiers.ch)

## Vadt

**La Fraternité (CSP-VD)** Place Arlaud 2, 1003 Lausanne,  
T +41 21 213 03 53, [frat@csp-vd.ch](mailto:frat@csp-vd.ch), [www.csp.ch](http://www.csp.ch)

**Collectif des Sans-Papiers de La Côte** c/o l'autre syndicat,  
5, chemin du Ruttet, 1196 Gland, T +41 22 362 69 88,  
[lacote@sans-papiers.ch](mailto:lacote@sans-papiers.ch), [www.sans-papiers.ch](http://www.sans-papiers.ch)

**Collectif droit de rester** coordination Asile-Migration,  
Case postale 5744, 1002 Lausanne, [collectif@stoprenvoi.ch](mailto:collectif@stoprenvoi.ch),  
[www.droit-de-rester.blogspot.com/p/propos-du-collectif.html](http://www.droit-de-rester.blogspot.com/p/propos-du-collectif.html)

### **Collectif vaudois de soutien aux sans-papiers (CVSSP)**

Case postale, 1000 Lausanne, T +41 76 432 62 67,  
[anne@sans-papiers-vd.ch](mailto:anne@sans-papiers-vd.ch), [www.sans-papiers-vd.ch](http://www.sans-papiers-vd.ch)

## Vadt

**Syndicat Unia** Place de la Riponne 4, 1002 Lausanne,  
T +41 21 310 66 00, [www.vaud.unia.ch](http://www.vaud.unia.ch), [www.unia.ch](http://www.unia.ch)

## Valis

**Centre suisse-immigrés (CSI)** Rue de l'Industrie 10,  
Case postale 280, 1950 Sion, T +41 27 323 12 16, [csivs@bluewin.ch](mailto:csivs@bluewin.ch)

## Cyrih

### **Sans-Papiers-Anlaufstelle Zürich (SPAZ)**

Birmensdorferstrasse 200, Postfach 1536, 8026 Zürich,  
T +41 43 243 95 78, [zuerich@sans-papiers.ch](mailto:zuerich@sans-papiers.ch), [www.sans-papiers.ch](http://www.sans-papiers.ch)

### **FIZ Fachstelle Frauenhandel und Frauenmigration**

Badenerstrasse 682, 8048 Zürich, T +41 44 436 90 00,  
[contact@fiz-info.ch](mailto:contact@fiz-info.ch), [www.fiz-info.ch](http://www.fiz-info.ch)

**Colectivo Sin Papeles Zurich** Postfach, 8023 Zürich,  
[colectivosinpapeleszurich@yahoo.es](mailto:colectivosinpapeleszurich@yahoo.es)

**Gewerkschaft Unia** Stauffacherstrasse 60, 8004 Zürich,  
T +41 44 296 18 18, [www.zuerich-schaffhausen.unia.ch](http://www.zuerich-schaffhausen.unia.ch), [www.unia.ch](http://www.unia.ch)

**Meditrina (Qendra Shëndetësore)** Kronenstrasse 10, 8006 Zürich,  
T +41 44 360 28 72, [www.srk-zuerich.ch/srk/lch-suche-Hilfe/fuer-Migrantinnen/Meditrina/index.php](http://www.srk-zuerich.ch/srk/lch-suche-Hilfe/fuer-Migrantinnen/Meditrina/index.php)

**SRK Kanton Zürich, Rechts- und Rückkehrberatung im Flughafengefängnis Zürich-Kloten** Kronenstrasse 10,  
8006 Zürich, T +41 44 360 28 60, [www.srk-zuerich.ch/srk/Was-wir-tun/Migration-Asyl/Sozial-Rechts-Rueckkehrberatung/index.php](http://www.srk-zuerich.ch/srk/Was-wir-tun/Migration-Asyl/Sozial-Rechts-Rueckkehrberatung/index.php)

**Augenauf** Postfach, 8026 Zürich, T +41 44 241 11 77,  
[zuerich@augenauf.ch](mailto:zuerich@augenauf.ch), [www.augenauf.ch](http://www.augenauf.ch)

## Zvicër në përgjithësi

**Sans-Papiers** [www.sans-papiers.ch](http://www.sans-papiers.ch) (informata të përgjithshme dhe veprime politike)

**Unia Zentralsekretariat** Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15,  
T +41 31 350 21 11, [www.unia.ch](http://www.unia.ch)

**Avokate/ët** Demokratische Jurist/-innen Schweiz, [www.djs-jds.ch](http://www.djs-jds.ch)

### **Këshillimore shëndetësore për Sans-Papiers**

[www.sante-sans-papiers.ch](http://www.sante-sans-papiers.ch)

**SRK (Kryqi i Kuq Zviceran)** [www.transkulturelle-kompetenz.ch](http://www.transkulturelle-kompetenz.ch),  
vgl. Sans-Papiers

### **Broshura për tema shëndetësore në gjuhë të ndryshme**

[www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)

### **Informata dhe këshillime me E-Mail në 16 gjuhë të ndryshme**

[www.migraweb.ch](http://www.migraweb.ch)

## Ndërkombëtare

**Politika dhe fushatat** Platform for International Cooperation on Undocumented Migrants (PICUM), [www.picum.org](http://www.picum.org)

**Adresat në tërë Evropën** European Network against nationalism, racism, fascism and in support of migrants and refugees,  
[info@unitedagainstracism.org](mailto:info@unitedagainstracism.org), [www.unitedagainstracism.org](http://www.unitedagainstracism.org)

**Informata dhe këshillime me E-Mail mbi të drejtën e qëndrimit në Evropë në gjashtë gjuhë të ndryshme** [www.w2eu.info](http://www.w2eu.info)

The logo for UNIA, featuring the word "UNIA" in white, bold, sans-serif capital letters inside a black speech bubble shape with a tail pointing downwards.

**UNIA**

**Die Gewerkschaft.  
Le Syndicat.  
Il Sindacato.**



Kjo Broshurë është botuar nga Sindikata Unia dhe Këshillimorja «Sans-Papier», dhe është përkrahur nga Juristët/et demokratik/e të Zvicrës, Fondacioni Gertrud Kurz dhe HEKS – Pika e kontaktit të drejtat e njeriut.